VENDIM
Nr.181, datë 17.3.2010

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT DHE PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 201, datë 17.12.2009 "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore kryesohet nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe në përbërje ka këta anëtarë:

a) Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit;

b) Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

c) Ministrin e Brendshëm;

ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Statistikave;

d) Drejtorin e Drejtorisë së Statistikave Ekonomike në INSTAT;

dh) Kryeregjistruesin e Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë;

e) Drejtorin e Departamentit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj në Kryeministri;

ë) Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave Bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit;

f) Drejtorin e Përgjithshëm të Blegtorisë pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit;

g) Rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.

2. Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore mblidhet në javën e fundit të çdo muaji. Mbledhjet e tij kryesohen nga kryetari i komisionit e, në mungesë të tij, nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit. Mbledhjet e këtij komisioni do të zhvillohen në selinë e Kryeministrisë.

3. Në mbledhjet e komisionit, veç anëtarëve, marrin pjesë edhe specialistët e nevojshëm sipas specifikës së çështjes, që do të diskutohet, dhe vendimit që është marrë paraprakisht nga Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore.

4. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës së Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it. Thirrja e mbledhjeve kryhet me anë të një njoftimi, i cili duhet t'i transmetohet çdo anëtari të komisionit jo më vonë se 7(shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar në njoftimin për mbledhje. Në njoftim përcaktohen data, ora e mbledhjes dhe rendi i ditës. Njoftimi shoqërohet me materialet, që do të shqyrtohen në mbledhje, të përgatitura nga sekretariati i komisionit, pasi të jetë marrë, paraprakisht, miratimi nga kryetari i këtij komisioni.

5. Mbledhjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore e deklaron të hapur kryetari i komisionit, pasi ka verifikuar nëse në mbledhje marrin pjesë mbi 50% e anëtarëve. Për të gjitha çështjet, që diskutohen në mbledhje, vendoset me votim me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Për çdo mbledhje të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore mbahet procesverbal, i cili zbardhet nga sekretariati i komisionit brenda pesë ditëve nga data e mbledhjes. Në procesverbal përcaktohen, ndërmjet të tjerave:

- numri dhe tematika e mbledhjes;

- data, koha e fillimit dhe e mbylljes së mbledhjes;
- emri i drejtuesit dhe i sekretarit të mbledhjes;
- emrat e anëtarëve të pranishëm;
- rendi i ditës;
- rezultatet e votimit.

7. Detyrat dhe kompetencat e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore janë të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr.10 201, datë 17.12.2009.

8. INSTAT-i ngarkohet me detyrën e sekretariatit të komisionit dhe ka këto detyra:

- Njoftimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, për mbledhjen e radhës;
- Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes;
- Përgatitjen e dokumentacionit bazë të mbledhjes;
- Përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, për mbledhjet komisionit, kryetarit të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore.
- Njoftimin e shpërndarjen e rendit të ditës, të projektakteve që do të shqyrtohen dhe të dokumentacionit, për mbledhjen e radhës, anëtarëve, brenda dy ditëve nga data e nënshkrimit nga kryetari;
- Mbajtjen e kopjeve të dokumentacionit, që do të shqyrtohet në mbledhje, dhe vendosjen e tij në dispozicion të anëtarëve;
- Përgatitjen e projektit të procesverbalit, të projektvendimeve të marra në mbledhje dhe ndjekjen e procedurave të miratimit e të arkivimit të tij;
- Përgatitjen e vendimeve që do të merren, në përputhje me rendin e ditës, të cilat ia bashkëngjit procesverbalit, të nënshkruar nga anëtarët.

9. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe INSTAT- i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha